

LIGJI PËR THEMELIMIN E AGJENCISË PËR PROMOVIMIN DHE MBËSHTETJEN E TURIZMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

TEKSTI I KONSOLIDUAR 1 - Ligji për themelimin e Agjencisë për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit në Republikën e Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103/2008; 156/2010; 59/2012; 187/2013 dhe 41/2014).

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë ligj themelohet Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit dhe rregullohen kompetencat, organizimin dhe punën e saj.

Statusi juridik

Neni 2

Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) ka cilësinë e personit juridik.

Emri i tërësishëm i Agjencisë është AGJENCIA PËR PROMOVIMIN DHE MBËSHTETJEN E TURIZMIT.

Emri i shkurtër i Agjencisë është APMT.

Selia e Agjencisë është në Shkup, ndërsa mund të ketë pjesë organizative në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit pa cilësinë e personit juridik.

Emri i Agjencisë në qarkullimin ndërkombëtar është AGENCY FOR PROMOTION AND SUPPORT OF TOURISM.

Kompetencat e Agjencisë

Neni 3

Kompetencat themelore të Agjencisë janë:

- Avancimi dhe promovimi i turizmit,
- Prezantimi profesional i të gjitha segmenteve dhe rajoneve të ofertës turistike,
- Përgatitja e analizave për potencialet e tregut vendas dhe të huaj turistik,
- Përgatitja dhe realizimi i Programit për promovimin dhe mbështetjen e turizmit, i cili do t’i përfshijë të gjitha segmentet, por edhe rajonet e ofertës turistike,
- Përgatitja e analizave për rezultatet e arritura nga zbatimi i Programit për promovimin dhe mbështetjen e turizmit,
- Zbatimi i procedurës për subvencionimin e qarkullimit të huaj të organizuar turistik në Republikën e Maqedonisë,
- Formimi dhe zhvillimi i një sistemi unik turistik informativ dhe lidhja e tij me sistemet e tjera informative në vend dhe jashtë vendit,

- Bashkëpunimi me operatorët turistikë për tërheqjen e një numri sa më të madh të turistëve,
- Bashkëpunimi me sipërmarrësit dhe kompanitë private (vendase dhe të huaja),
- Propozimi i masave dhe aktiviteteve cilësore për promovimin dhe mbështetjen e turizmit në pjesët e pazhvilluara të vendit,
- Promovimi aktiv i potencialit të tërësishëm turistik të Republikës së Maqedonisë në vend dhe jashtë vendit,
- Sigurimi i materialit informativ propagandistik për promovimin e vlerave turistike (publikime të shtypura, audio dhe video materiale, internet prezantime, suvenire e tjerë),
- Zhvillimi dhe promovimi i produkteve të reja integrale turistike,
- Bashkëpunimi me institucionet kompetente në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës, ngjarjeve turistike-kulturore, logjistikës në turizëm, veprimtarisë shkencore-arsimore dhe gjërave të tjera të cilat kontribuojnë për zhvillimin dhe ngritjen cilësore të ofertës turistike,
- Bashkëpunimi dhe drejtimi i punës së njësive të vetëqeverisjes lokale në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm cilësor dhe promovimit të ofertës turistike, e cila do t'i përfshijë edhe ngjarjet e organizuara lokale turistike,
- Nxiti dhe koordinon të gjitha organizatat, odat, asociacionet, shoqatat turistike dhe institucionet e tjera të sferës së turizmit dhe hotelerisë, me qëllim të avancimit dhe promovimit të turizmit,
- Nxiti dhe drejton një bashkëpunim ndërkomunal dhe rajonal për promovimin e përbashkët të turizmit në rajonet e cekura,
- Inicimi dhe realizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me organizatat dhe institucionet e ngjashme,
- Merr pjesë në tërheqjen e investimeve në turizëm në Republikën e Maqedonisë dhe
- Kryen aktivitete të tjera në përputhje me ligjin dhe Statutin.

Parimet e punës së Agjencisë

Neni 4

Puna e Agjencisë bazohet në këto parime:

- a) aftësia;
- b) profesionalizmi;
- c) transparenca;
- ç) qëndrueshmëria
- d) përgjegjësia për punën dhe rezultatet e arritura.

Programi

Neni 5

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Agjencisë, miraton programin vjetor për promovimin dhe mbështetjen e turizmit (në tekstin e mëtejshëm: programi) brenda 30

ditëve nga dita e shpalljes së Buxhetit të Republikës së Maqedonisë në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Mjetet për themelimin dhe kryerjen e punëve

Neni 6

Mjetet për themelimin e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Mjetet për kryerjen e punëve të Agjencisë sigurohen nga këto burime:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë, në bazë të programit të miratuar paraprakisht,
- Të ardhurat personale,
- Donacionet dhe
- Burime të tjera në përputhje me ligjin.

Statuti i Agjencisë

Neni 7

Agjencia ka Statutin me të cilin rregullohet sidomos:

- mënyra e kryerjes së kompetencave të fushëveprimit të Agjencisë,
- kompetencat e Bordit Drejtues dhe drejtorit dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella,
- të drejtat, kompetencat dhe përgjegjësitë e të punësuarve,
- organizimi i brendshëm i Agjencisë dhe
- gjërat e tjera.

Organet e Agjencisë

Neni 8

Organet e Agjencisë janë Bordi Drejtues dhe drejtori.

Bordi Drejtues

Neni 9

Me Agjencinë drejton (menaxhon) Bordi Drejtues i Agjencisë, i cili përbëhet nga shtatë anëtarë.

Anëtarët e Bordit Drejtues të Agjencisë i emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Për anëtarë të Bordit Drejtues emërohen: katër anëtarë me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, një anëtar me propozim të Ministrisë të Ekonomisë dhe dy

anëtarë me propozim të Odave Ekonomike, sipas parimit të rotacionit të Odave të regjistruara ekonomike në Republikën e Maqedonisë.

Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues zgjat katër vite me të drejtën e përzgjedhjes së serishme.

Anëtarët e Bordit Drejtues kanë të drejtën e kompensimit. Kompensimin e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Anëtarët e Bordit Drejtues zgjedhin kryetarin e Bordit Drejtues në seancën e parë.

Bordin Drejtues e mbledh dhe me të kryeson kryetari i Bordit Drejtues.

Bordi Drejtues mblidhet së paku një herë në çdo tre muaj me kërkesë të kryetarit, të një të tretës së anëtarëve të Bordit Drejtues ose të drejtorit.

Bordi Drejtues mund të marrë vendime të plotfuqishme nëse në seancë janë të pranishëm të paktën pesë anëtarë, ndërsa vendimet i merr me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 10

Bordi Drejtues i Agjencisë:

- 1) miraton Statutin e Agjencisë;
- 2) miraton programin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar;
- 3) ndihmon drejtorin e Agjencisë duke i dhënë mendime dhe propozime për zbatimin e programit;
- 4) *është fshirë 2*
- 5) shqyrton dhe miraton raportet për aktivitetet e Agjencisë dhe
- 6) kryen edhe aktivitete të tjera në përuthje me këtë ligj dhe Statutin e Agjencisë.

Neni 11

Një anëtar i Këshillit Drejtues shkarkohet në rastet e mëposhtme:

- pas skadimit të mandatit,
- me kërkesën e tij,
- nëse është dënuar për kryerjen e një vepre penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë, me të cilin është shqiptuar dënimi me burg me kohëzgjatje prej së paku gjashtë muajsh,
- nëse ndodh një paaftësi të përhershme ose të përkohshme për kryerjen e pandërprerë të funksionit për më shumë se gjashtë muaj pa ndërprerje ose nëse ndodh vdekje dhe
- kur do të konstatohet se vepron në kundërshtim me këtë ligj.

Drejtori i Agjencisë

Neni 12

Me punën e Agjencisë drejton drejtori, të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Për emërimin e drejtorit shpallet një shpallje publike në tri gazeta të përditshme, të cilat botohen në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat në njërin e gazetave të cilat botohen në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve, të cilët flasin një gjuhë zyrtare që është e ndryshme nga gjuha maqedonase.

Për drejtor mund të emërohet një person i cili plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit, me një vendim gjyqësor të formës së prerë, kundër tij nuk është shqiptuar një dënim ose sanksion për kundërvajtje për ndalimin e kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka fituar të paktën 240 kredi sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Kredive (SETK) ose ka përfunduar shkallën VII/1;
- 4) të ketë së paku pesë vjet përvojë pune;
- 5) posedon një nga këto certifikata të njohura ndërkombëtare për njohjen aktive të gjuhës angleze, e cila nuk do të jetë më e vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT - të paktën 74 pikë,
 - IELTS – të paktën 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) – të paktën niveli B2,
 - FCE (Cambridge English: First) – ka kaluar provimin,
 - BULATS – të paktën 60 pikë dhe
 - APTIS – të paktën niveli B2 dhe
- 6) ka kaluar testin psikologjik dhe testin e integritetit.

Neni 13

Drejtori dërgon një raport për punën e tij së paku dy herë në vit në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, më së voni një muaj pas përfundimit të periudhës së raportit.

Në raportin e paragrafit 1 të këtij neni, drejtori sidomos ka obligim të dorëzojë të dhënat për llojin dhe vëllimin e punëve të kryera gjatë kryerjes së punëve të Agjencisë.

Nëse në raportin e punës konstatohen mangësi në punën financiare të Agjencisë, drejtori është i detyruar t'i heqë ato në gjashtë muajt e ardhshëm.

Neni 14

Drejtori i Agjencisë kryen këto punë:

- përfaqëson Agjencinë,
- organizon punën dhe menaxhon me shërbimet profesionale të Agjencisë,
- propozon programin dhe planet aksionare të Agjencisë,
- informon Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për të gjitha pengesat ekzistuese administrative dhe ligjore për promovimin dhe mbështetjen e turizmit dhe propozon masa për eliminimin e tyre,
- zbaton vendimet e Bordit Drejtues,
- kujdeset për funksionimin ligjor dhe shpenzimin e mjeteve financiare,
- kryen harmonizimin e aktiviteteve afariste të Agjencisë,

- përgatit programin vjetor të punës dhe planin financiar vjetor për mjetet e nevojshme dhe burimet e tyre,
- miraton akte për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci dhe akte të tjera të Agjencisë, miraton planet vjetore për punësim në Agjenci, si dhe vendos për të drejtat e marrëdhënieve të punës të të punësuarve në Agjenci.
- miraton akte individuale për të punësuarit nga sfera e marrëdhënieve të punës;
- vendos edhe për çështje të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me Statutin e Agjencisë.

Neni 14-a

Drejtori i Agjencisë miraton një vendim për subvencionimin e qarkullimit të huaj të organizuar turistik brenda 30 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm në përputhje me rregullën e nenit 57, paragrafit 2 të Ligjit për veprimtarinë turistike.

Kundër vendimit të paragrafit 1 të këtij neni mund të parashtrohet një ankesë brenda 15 ditëve deri në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurën e Marrëdhënieve të Punës në shkallë të dytë.

Agjencia mban një regjistër të kërkesave të parashtruara dhe vendimeve të lëshuara për subvencionimin e qarkullimit të huaj të organizuar turistik.

Drejtori i Agjencisë përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për subvencionimin e qarkullimit të huaj të organizuar turistik.

Neni 15

Drejtori shkarkohet para skadimit të mandatit në rastet e mëposhtme:

- me kërkesën e tij,
- nëse nuk punon dhe vepron në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e Agjencisë ose në mënyrë të paarsyeshme nuk zbaton vendimet e Bordit Drejtues ose vepron në kundërshtim me to,
- nëse me punën e tij të papërgjegjshme dhe të gabuar shkakton probleme në kryerjen e punëve të Agjencisë dhe shkakton dëme,
- nëse neglizhon ose nuk përmbush detyrimet dhe me këtë shkaktohen probleme në kryerjen e veprimtarisë që është në interes të Agjencisë,
- nëse nuk dorëzon raport në përputhje me nenin 13, paragrafin 1 të këtij ligji,
- nëse edhe pas skadimit të afatit të përcaktuar në nenin 13, paragrafin 3 të këtij ligji nuk eliminon mangësitë dhe/ose në atë afat përsëri ka mangësi në punën financiare,
- nëse parashtron një dorëheqje me shkrim,
- nëse është dënuar për kryerjen e veprës penale me vendim gjyqësor të formës së prerë, me të cilin është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muajsh,
- nëse tek ai ndodh një paaftësi të përhershme ose të përkohshme për kryerjen e pandërprerë të funksionit të tij për më shumë se gjashtë muaj pa ndërprerje ose nëse ndodh vdekje dhe
- fiton kushtet për të realizuar të drejtën e pensionit.

Neni 16

Drejtori përgjigjet për punën dhe ligjshmërinë e punës para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 17

Nëse mandati i drejtorit dhe anëtarit të Bordit Drejtues ka skaduar, ndërsa procedura për emërimin e drejtorit të ri dhe anëtarëve të rinj nuk ka përfunduar, drejtori ekzistues dhe anëtarët e Bordit Drejtues vazhdojnë të kryejnë funksionin e tyre deri në emërimin e drejtorit të ri dhe anëtarëve të rinj.

Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen edhe kur drejtori dhe anëtari i Bordit Drejtues janë të shkarkuar para skadimit të mandatit.

Këshilli

Neni 17-a

Drejtori, me qëllim të përgatitjes dhe zbatimit më të mirë të Programit për promovimin dhe mbështetjen e turizmit, formon një Këshill që përbëhet nga 15 anëtarë, si më poshtë:

- katër përfaqësues nga dhomat ekonomike turistike,
- shtatë përfaqësues nga shoqatat, asociacionet dhe federatat turistike të Republikës së Maqedonisë,
- dy përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë të fushës së turizmit në Republikën e Maqedonisë,
- një ekspert nga fusha e turizmit dhe marketingut dhe
- një përfaqësues nga Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL).

Neni 17-b

Përfaqësuesit e Këshillit emërohen për dy vjet, me të drejtën e rizgjedhjes (përzgjedhjes së serishme).

Këshillin e mbledh dhe me të kryeson kryetari i Këshillit, i cili zgjidhet nga radha e përfaqësuesve të këshillit, me shumicën e të pranishmëve në seancën konstituive. Këshilli mund të ketë gjithashtu edhe një Zëvendës-kryetar, i cili zgjidhet nga radha e përfaqësuesve të Këshillit, me shumicën e të pranishmëve në seancën konstituive.

Këshilli mbledhet së paku një herë në tre muaj me kërkesë të drejtorit, të kryetarit të Këshillit ose të një të tretës së përfaqësuesve.

Këshilli merr vendime me shumicën e thjeshtë të të pranishmëve.

Neni 17-c

Këshilli kryen këto punë:

- bashkëpunon gjatë përgatitjes së programit vjetor të punës të Agjencisë dhe dokumenteve të tjera, përmes përgatitjes së mendimeve dhe rekomandimeve profesionale,
- përgatit analizën e rezultateve të arritura nga zbatimi i programit vjetor të Agjencisë, duke dërguar mendime profesionale deri te drejtori i Agjencisë,
- përgatit hulumtime dhe analiza, me kërkesë të drejtorit të Agjencisë dhe me një iniciativë personale,
- përgatit raporte në bazë të hulumtimeve dhe analizave të kryera, me rekomandime dhe udhëzime për ndërmarrjen e aktiviteteve të mëtejshme në kompetencë të Agjencisë dhe
- kryen punë të tjera me kërkesë të drejtorit të Agjencisë.

Të drejtat dhe kompetencat e të punësuarve

Neni 18

Të punësuarit në Agjenci kanë statusin e zyrtarëve administrativë. Për klasifikimin, punësimin, avancimin, zhvillimin dhe trajnimin profesional, matjen e efektit dhe çështjet e tjera që lidhen me marrëdhëniet e punës të zyrtarëve administrativë në Agjenci zbatohen dispozitat e Ligjit për zyrtarët administrativë.

Neni 19

Për realizimin e punëve të nenit 4 të këtij ligji, Agjencia mund në bazë të një marrëveshjeje të përdorë shërbimet e personave juridikë dhe fizikë nga vendi dhe jashtë vendit.

Konflikti i interesave

Neni 20

Në rast se ka konflikt të interesave, zbatohet Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave.

Neni 21

Për Statutin, programin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar të Agjencisë pëlqimin e jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Mbikëqyrja e punës

Neni 22

Ministria e Ekonomisë kryen mbikëqyrjen për ligjshmërinë e punës së Agjencisë.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 23

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do t'i emërojë drejtorin e Agjencisë dhe anëtarët e Bordit Drejtues.

Agjencia do të fillojë me punë brenda 30 ditëve nga dita e emërimit të drejtorit.

Këshilli Drejtues, brenda 30 ditëve nga dita e themelimit të tij, miraton Statutin e Agjencisë.

Të punësuarit e Ministrisë së Ekonomisë, të cilët kanë kryer aktivitete të fushës së promovimit të turizmit, i ndërmerr Agjencia në përputhje me aktet për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në Agjenci.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".